



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2023:117047

Datë: 21.03.2024

Numri i dokumentit: 05486622

C.nr.432/2023

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Berkan Hamza, në çështjen juridike kontestimore të paditëses F.R nga Rahoveci, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson avokati M.B nga Rahoveci, ndaj të paditurës S me seli në Prishtinë, për shkak të objektit të kontestit – kompensimi i dëmit material dhe jomaterial, me vlerën e objektit të kontestit prej 10,000.00 euro, jashtë seancës, më datën 21.03.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

KONSTATOHET e tërhequr padia e paditëses F.R nga Rahoveci, ndaj të paditurës S me seli në Prishtinë, në çështjen kontestimore C.nr.432/2023.

Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësja F.R nga Rahoveci, më datën 24.05.2023, në këtë gjykatë ka parashtruar padinë ndaj të paditurës S me seli në Prishtinë, për shkak të objektit të kontestit – kompensimi i dëmit material dhe jomaterial, me vlerën e objektit të kontestit prej 10,000.00 euro.

Lidhur me këtë çështje kontestimore, kjo gjykatë ka caktuar seancën përgatitore për datën 07.03.2024, në të cilën seancë ka prezantuar përfaqësuesi i autorizuar i paditëses, ndërsa e paditura përkundër që ka qenë e ftuar në mënyrë të rregullt, në seancën përgatitore nuk ka prezantuar dhe mungesën e tyre saj e ka arsyetuar. Përfaqësuesi i autorizuar i paditëses në seancën përgatitore ka deklaruar se e tërheq padinë e parashtruar në këtë çështje kontestimore.

Gjykata, të paditurës i ka dorëzuar procesverbalin e seancës përgatitore të datës 07.03.2023 në të cilën përfaqësuesi i autorizuar i paditëses është tërhequr nga padia, por faktit se ka kaluar afati 7 ditor nga dita e pranimit të këtij procesverbali, e njëjta nuk është deklaruar lidhur me tërheqjen e padisë.

Kështu, sipas nenit 261.1 të LPK-së “Paditësi mund ta tërheqë padinë pa pëlqimin e të paditurit deri në momentin në të cilin i padituri e paraqet në gjykatë përgjigjen në padi”. Ndërsa sipas nenit 261.2 “Padia mund të tërhiqet edhe më vonë, deri në përfundimin e

shqyrtimit kryesor, në qoftë se i padituri e jep pëlqimin për një gjë të tillë. Po që se i padituri brenda shtatë (7) ditësh nga dita e njoftimit për tërheqjen e padisë nuk deklarohet për këtë gjë, do të konsiderohet se e ka dhënë pëlqimin për tërheqjen e padisë”.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale, që secila palë t'i bartë këto shpenzime, është marrë në kuptim të nenit 456.1 të LPK-së.

Prandaj, nga ajo që u tha më lartë, kjo gjykatë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, e në bazë të nenit 261.2, 262.3 dhe 262.4 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil

C.nr.432/2023, më datën 21.03.2024

Gjyqtari
Berkan Hamza

KËSHILLË JURDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit.